



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM-SHPËTIMIT (QKKSH)

DHE

**QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE
PËR
BASHKËPUNIMIN NË OPERACIONET E KËRKIM SHPËTIMIT
NË RAST INCIDENTEVE AERONAUTIKE DHE DETARE
NË RAJONIN E KËRKIM SHPËTIMIT TË RSH**

TIRANË 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit
(QKKSH)

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
(QKUM)

Nr 509 Prot, datë 13, 12, 2024

Nr 660 Prot, datë 13, 12, 2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET**

**QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM-SHPËTIMIT (QKKSH)
DHE
QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE**

**PËR
BASHKËPUNIMIN NË OPERACIONET E KËRKIM SHPËTIMIT
NË RAST TË INCIDENTEVE AERONAUTIKE DHE DETARE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
NË RAJONIN E KËRKIM SHPËTIMIT TË RSH**

HYRJE

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim referuar si “Marrëveshje”), është hartuar nga/dhe ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrojtjes në RSH (në vijim referuar si “QKKSH”) dhe Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore në RSH, (në vijim referuar si “QKUM”), referuar në vijim si “Palët” dhe në referencë si “Pala”.

Organizimi i shërbimit të kërkim shpëtimit dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë për këtë shërbim përcaktohen nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe aktet ligjore e nënligjore kombëtare.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (si dhe institucionet e tjera shëndetësore shtetërore dhe private) në bazë të Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit dhe Planit të Veprimit të Tij, ka përgjegjësinë dhe detyrimin e saj për të bashkëpunuar në operacionet e kërkim shpëtimit në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH.

Bashkëpunimi ndërmjet QKKSH dhe QKUM (strukturë, përkatësisht në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), në operacionet e kërkim shpëtimit në rast të incidenteve aeronautike, dhe detare në rajonin e kërkim shpëtimit (tokësore, detare dhe në ujërat e brendshme) të Republikës së Shqipërisë, është i domosdoshëm dhe në interes të minimizimit të humbjeve të jetëve njerëzore. Të dy institucionet angazhohen që të koordinojnë dhe operojnë në raste fatkeqësish të ndryshme në rast të incidenteve aeronautike dhe detare në rajonin e kërkim shpëtimit (tokësor, detar apo në ujërat e brendshme) të Republikës së Shqipërisë, kur jeta njerëzore është në rrezik.

Referencat ligjore ku mbështetet Marrëveshja:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Ndërkombëtare e Aviacionit Civil "ICAO" (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil), Chikago 1944 (ICAO Aneksi 12 "Kërkim shpëtimi");
- Ligji nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 10435, datë 23.06.2011 "Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në RSH";
- Ligji nr. 147/2014 "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore";
- VKM nr. 742, datë 16.10.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit";
- VKM nr. 729, datë 13.11.2019 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, dhe Planit të Veprimit të Tij";
- VKM NR 867, datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore".

DUKE QENË SE:

Palët ndajnë vizionin e forcimit të bashkëpunimit në lidhje me kontributet e secilës prej tyre, për përballimin e situatave të krijuara në operacionet e kërkim shpëtimit, për një angazhim të shpejtë dhe profesional, dhe vënien në funksion të plotë të kapaciteteve për menaxhimin e fatkeqësisë,

QKKSH dhe QKUM, angazhohen plotësisht për zbatimin e kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Të dyja palët janë të detyruara të koordinojnë dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre për çdo ndryshim të statusit operacional, apo të mjeteve të tyre të operimit, të cilat ndikojnë në procedurat e specifikuar në këtë Marrëveshje.

PËR KËTË ARSYE, Palët bien dakord si më poshtë:

Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme do aplikohen në këtë Marrëveshje:

Shërbimi i Kërkim Shpëtimit (“SAR”)	Është Shërbimi i Kërkim Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
“Kërkim”	Një operacion, zakonisht i koordinuar nga një qendër e koordinimit të shpëtimit, duke përdorur personelin dhe mjetet në dispozicion për të gjetur personat në rrezik.
“Shpëtim”	Operacioni i zhvendosjes/i marrjes së personave në rrezik, mbështetja e tyre me nevojat bazë mjekësore ose nevoja të tjera, si dhe dërgimi i tyre në një vend të sigurt.
“Incident kërkim-shpëtimi”	Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë operacionet SAR.
“Qendra e Koordinimit të Shpëtimit” (QKSH/RCC)	Qendra nga e cila drejtohet dhe koordinohet një incident SAR (QKSH) ose RCC.
“Koordinimi”	Bashkimi i strukturave dhe elementeve SAR, për të siguruar përgjigje efikase të kërkim-shpëtimit. Një njësi SAR duhet gjithmonë të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të koordinimit dhe strukturat e tjera duhet të bashkëpunojnë me këtë njësi për të dhënë përgjigjen më të mirë të mundshme me burimet që kanë në dispozicion.
“Vendngjarje”	Zonë kërkimi ose vendi aktual i rrezikut.
“Koordinator në vendngjarje” (OSC)	Një person i caktuar për të koordinuar operacionet e kërkimit dhe të shpëtimit brenda një zone të specifikuar.
Urgjencë Mjekësore	Urgjenca mjekësore është një situatë ose gjendje shëndetësore që kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të shpëtuar jetën, për të parandaluar përkeqësimin e një gjendjeje serioze, ose për të shmangur dëmtimet e rënda fizike apo neurologjike. Këto situata mund të ndodhin si

pasojë e një sëmundjeje, aksidenti, traume, katastrofe apo ndonjë gjendjeje akute të papritur që kërcënon jetën ose mirëqenien e individit.

Njësia e Koordinimit

Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore është pjesë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, e cila bashkërendon komunikimin e të gjithë sistemit të komandë kontrollit të urgjencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë.

Salla e maksiemergjencës

Sallë që aktivizohet për ngjarje të jashtëzakonshme me stafin on call.

Mjeku primar

Mjeku përgjegjës i turnit që ndjek menaxhimin e njësisë së koordinimit, rastet jashtë protokollit, emergjencat madhore, komunikimin me shërbimet e tjera të urgjencës dhe me eprorët.

MEDEVAC

Evakuimi i personave në një vend ku ata mund të marrin kujdes mjekësor.

Neni 1

Objekti

- 1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është vendosja e bashkëpunimit mes strukturave përgjegjëse shtetërore, në rast të një aksidenti aeronautik, detar apo në ujërat e brendshme në Rajonin e Kërkim Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Të Drejtat dhe Detyrimet e të dyja Palëve

2.1. Përgjegjësitë e QKKSH-së.

2.1.1 Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit (QKKSH), është pikë kombëtare kontakti për operacionet e kërkim-shpëtimit. Ajo bashkëvepron me institucionet shtetërore, entet private (privatët duhet të jenë të regjistruar pranë shërbimeve të urgjencës përkatëse) dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përgjigjet për detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH.

2.1.2 QKKSH, koordinon në nivel kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

- 2.1.3 Bashkëpunon dhe koordinon me Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) në rast të një incidenti aeronautik, detar dhe në ujërat e brendshme në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH.
- 2.1.4 QKKSH bën menjëherë njoftimin e QKUM, ose njoftohet nga QKUM (në varësi se kush njoftohet i pari) në rast të një aksidenti aeronautik, detar apo në ujërat e brendshme në rajonin e kërkim shpëtimit (tokësore, detar dhe në ujërat e brendshme) të Republikës së Shqipërisë.
- 2.1.5 QKKSH gjatë evakuimit duhet të marrë parasysh kapacitetin e objektit të shpëtimit për të arritur të mbijetuarit në kohën më të shkurtër të mundshme.
- 2.1.6 QKKSH bashkëpunon me QKUM/Ministrinë e Shëndetësisë, për menaxhimin në afërsi të rajonit të aksidentit duke dhënë informacion rreth numrit të mbijetuarve dhe mundësinë e hospitalizimit të tyre.
- 2.1.7 QKKSH njofton menjëherë QKUM nëse kërkohet evakuim mjekësor MEDEVAC. QKUM vlerëson rastet e evakuimit sipas protokollit. Vendimi final mbi mundësinë e kryerjes së evakuimit mjekësor merret nga kapiteni i anijes ose piloti komandues në detyrën e evakuimit. (vlerësimin mjekësor nuk e bën kapiteni apo piloti!)
- 2.1.8 Në rast të një evakuimi mjekësor MEDEVAC, QKKSH analizon rreziqet e qenësishme të një operacioni të tillë, si për personin/personat në rrezik për jetën, ashtu dhe për personelin e shpëtimit.
- 2.1.9 QKKSH angazhon të gjitha burimet e informacionit që ka në dispozicion, në bordin e anijes dhe mban kontakt të vazhdueshëm me QKUM, duke dhënë informacione mjekësore të detajuara, për gjendjen e përgjithshme të pacientëve, si dhe për çdo ndryshim të gjendjes së tyre.
- 2.1.10 QKKSH merr informacion nga mjeti lundrues rreth identitetit të personit/personave që kërkojnë ndihmë; grupin e gjakut, problemin shëndetësor apo dëmtimet që i janë shkaktuar dhe këto të dhëna i transmeton menjëherë QKUM-së.
- 2.1.11 QKKSH merr informacion të plotë nëse mjeti lundrues ka një platformë për uljen e helikopterit, e nëse po kërkon që të krijohen kushtet për uljen e helikopterit dhe evakuimin e personit/personave.
- 2.1.12 Para se të kryhet evakuimi nga bordi i anijes, personi i dëmtuar, duhet të përgatitet para mbërritjes së helikopterit, për detajet e çdo medikamenti të përdorur, kartelën mjekësore, si dhe të jetë në pozicion të gatshëm për tu marrë nga helikopteri dhe bashkëpunon me QKUM.
- 2.1.13 QKKSH, në rastet kur personeli i kërkim shpëtimit ka evidentuar trupa të cilët kanë humbur jetën në rajonin e aksidentit, duhet të përpiloj një listë për të gjithë personat e që kanë humbur jetën dhe bashkëpunon me mjekësinë ligjore.
- 2.1.14 Shpall emrat e personave të humbur ose të dëmtuar, në përputhje me ligjet ndërkombëtare dhe Planin Kombëtar të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.
- 2.1.15 QKKSH, bën njoftimin e të afërmeve të personave që janë dëmtuar apo kanë humbur jetën.
- 2.1.16 Emrat e të mbijetuarve apo të personave të vdekur gjatë aksidenteve aeronautike, detare dhe në ujërat e brendshme nuk deklarohen derisa të njoftohen të afërmit e tyre. Kjo detyrë

do të kryhet nga Ministria e Mbrojtjes, ose nga Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit në bashkëpunim me policinë e shtetit.

2.1.17 QKKSH apo persona të strukturave të cilët kanë deklaruar kapacitete SAR në Planin Kombëtar të kërkim shpëtimit, për t'u angazhuar në operacionet e kërkim shpëtimit SAR, marrin pjesë në seminare, konferenca të përbashkëta, Workshop të organizuara nga QKUM.

2.2 Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM).

2.2.1 Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), siguron gatishmërinë, koordinon institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë për vënien në dispozicion të kapaciteteve materiale dhe njerëzore për mbështetjen e operacioneve SAR dhe trajtimin shëndetësor të personave në rrezik për jetën.

2.2.2 QKUM, gjatë operacioneve të kërkim shpëtimit reagon në kohë sa më të shpejtë me të gjitha kapacitetet dhe burimet e disponueshme në rast të incidenteve/aksidenteve aeronautike, detare dhe në ujërat e brendshme në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH në bashkëpunim me shërbimet e tjera të urgjencës pa cenuar vijueshmërinë normale të ofrimit të shërbimit mjekësor për pjesën tjetër të popullatës.

2.2.3 Në rast incidenti aeronautik, detar dhe në ujërat e brendshme në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH, ka Koordinatorin në Vendngjarje i cili informon në mënyrë të vazhdueshme. Këto informacione shkëmbehen me QKKSH.

2.2.4 QKUM, bën vlerësimin e personit/personave të aksidentuar për trajtimin parësor, mjekësor.

2.2.5 QKUM, bën këshillimin mjekësor të personelit në rajonin e aksidentit aeronautik apo në mjetin lundrues (nëse ka personel mjekësor), ose të ekuipazhit në lidhje me trajtimin/përdorimin e pajisjeve dhe medikamenteve që kanë në bord.

2.2.6 QKUM, bën këshillimin e të mbijetuarve në rastin e një incidenti ajror për dhënien e ndihmës së parë njëri-tjetrit nëse janë në gjendje.

2.2.7 QKUM, bën këshillimin e personelit të njërive të kërkim shpëtimit për dhënien e ndihmës së parë të mbijetuarve në rastin e një incidenti ajror, detar dhe në ujërat e brendshme në rajonin e kërkim shpëtimit të RSH.

2.2.8 QKUM në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë bën koordinim me spitalet shtetërore dhe private në afërsi të aksidentit duke garantuar transportin për trajtim spitalor të mbijetuarve.

2.2.9 QKUM, mban në gatishmëri të plotë për çdo evakuim mjekësor të gjitha asetet që disponon, pa cenuar vijueshmërinë normale të ofrimit të shërbimit mjekësor për pjesën tjetër të pupullatës.

2.2.10 QKUM, jep ndihmë ose këshilla mjekësore, duke përdorur shërbimet e asistencës telemjekësore (TMAS).

3.2.11 QKUM, merr pjesë në stërvitje/seminare trajnuese/konferenca të përbashkëta, të organizuara nga QKKSH.

Neni 3

Bashkëpunimi

Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të bashkëpunuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshje, si dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Forca Madhore

QKKSH dhe QKUM, nuk do të mbajnë përgjegjësi për ndonjë dështim apo vonesë në përmbushjen e kushteve të kësaj Marrëveshje, për arsye të Forcës Madhore.

Neni 5

Amendamentet

Marrëveshja përbën të gjithë bashkëpunimin e Palëve dhe asnjë kusht, detyrim, apo marrëveshje e cila ka për qëllim të modifikojë kushtet e kësaj Marrëveshje, nuk do të jetë e detyrueshme për t'u zbatuar përveç rasteve kur bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

Neni 7

Komunikimi

1. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e angazhimeve, sipas kësaj marrëveshje. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ose nëpërmjet postës elektronike.

2. Secila palë do të caktojë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të marrëveshjes. Personat e kontaktit do të jenë të disponueshëm për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve.

Neni 8

Konfidencialiteti

1. Secila palë angazhohet të mbrojë informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshje nga bërja publike në formë të pa autorizuar.

2. Palët bien dakord të mbikëqyrin në masën e kërkuar sipas legjislacionit të aplikueshëm, rregullat dhe rregulloret e tyre përkatëse, mbrojtjen e informacionit të marrë nga Pala tjetër.

Neni 9

Kohëzgjatja


1. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshje fillon në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zgjasë deri në një afat të pacaktuar, përveç rasteve kur palëve heqin dorë prej saj në formë të shkruar.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Marrëveshja mund të zgjidhet në çdo kohë nga secila palë. Zgjidhja e Marrëveshjes do të jetë efektive kur njëra palë njofton palën tjetër përkatësisht në formë të shkruar 3 (tre) muaj para në rast se njoftimi në fjalë për zgjidhje të Marrëveshjes, nuk është tërhequr/anuluar me miratimin e palëve përpara përfundimit të afatit. Ajo përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, nga 2 (dy) për secilën palë.

QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM SHPËTIMIT


KOLONEL FIQIRI HOXHA
KRYETAR



QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE


Dr. SKËNDER BRATAJ
DREJTOR

